**VENDIM**
**Nr. 392, datë 13.5.2020**

# PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË NJË SIPËRFAQEJE TË PASURISË ME NUMËR 108/169, ZONA KADASTRALE 2420, BASHKIA POGRADEC

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, për sipërfaqen prej 555 m², pjesë e pasurisë me numër 108/169, zona kadastrale 2420, fshati Leshnicë, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Korçë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, për sipërfaqen ndërtimore prej 555 m², sipas lidhjes nr. 1, të pasurisë me numër 108/169, zona kadastrale 2420, fshati Leshnicë, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec.
3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Korçë dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**Lidhja nr. 1**

| Nr. rendor | Qarku | Bashkia | Zona kadastrale | Adresa e pasurisë | Numri i pasurisë | Sipërfaqja m² | Sipërfaqja ndërtimore m² | Emërtimi i strukturës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Korçë | Pogradec | 2420 | Leshnicë | 108/169 | 3399 | 355 | Kantinë për prodhim vere, 1 kat. |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

# ÇERTIFIKATË

PËR VËRTETIM PRONËSIE

1847047

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. POGRADEC Zona Kadastrale Nr. 2420

Numri i Pasurisë 108/169 Volumi 10 Faqe 123

Adresa e Pasurisë LESHNICE

Lloji i Pasurisë ARE

Sipërfaqja Totale 3399.00 m2

Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

## KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| SHOQERIA | "OPTIMUM" 3 | SHPK | 1/1 | ÇERAAVE |

- është pronar i pasurisë me numër 108/169
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V 86 , L 108/58 , J 110 , P 108/54

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 12/6/2019 Nr. 2558

Data e lëshimit të çertifikatës 14/6/2019

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ... DREJTORIA VENDORE POGRADEC

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

| | |
|---|---|
| **AGJENÇIA SHTETËRORE E KADASTRËS**<br>**DREJTORIA VENDORE POGRADEC**<br><br>**DREJTOR**<br>**Natalja**<br><br>**HARTOGRAF D.MANCELLARI** | A. IDENTIFIKIMI I PASURISE<br>ZONA KADASTRALE **2420** NR. I PASURISE 108/ 169 Vol. 10 Fq. 123<br>INDEKSI I HARTES **K-34-114-(103-D).** SHKALLA 1:1000<br>ADRESA E PASURISE: Rrethi **Pogradec** O/F **Leshnice**<br>Rr/I. P/G Sh K Ap<br>B. KUFIZIMET<br>V. 86<br>L. 108/58<br>J. 110<br>P. 108/54<br>D. Data: / /2019<br>C. PRONARI/ET<br>**(I)"OPTIMUM 3" SHPK** |

